



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

**SHPLLJE KONKURIMI I HAPUR
PËR
VENDET VAKANTE PRANË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", neni 11, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, shpall konkurimin për pozicionet vakante:

Drejtoritë vendore të ASHK:

Berat, Krujë, Elbasan, Fier, Kavajë, Lushnje, Gjirokastrë, Tepelenë, Pogradec, Kukës, Lezhë, Shkodër, Sarandë, Vlorë dhe Tiranë.

Zyrat Vendore të ASHK:

Devoll, Kolonjë, Malësi e madhe, Himarë.

VENDET VAKANTE

- Përgjegjës Sektori, Kategoria: Kategoria: III-b dhe IV-a, Niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"
- Specialist, Kategoria: IV-b, Niveli minimal i diplomës "Bachelor"

KUSHTET DHE KRITERET E KONKURIMIT

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët:

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në legjisllacionin e shërbimit civil sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme, si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të Arsimit të Lartë, nivelit minimal "Bachelor" në profilet Inxhinieri Ndërtimi; Arkitekturë; Urbanistikë; Gjeoinformatikë; Gjeodezi; Topografi.
- Për pozicionet Përgjegjës Sektori, kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të nivelit minimal "Master Shkencor". Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- Për pozicionet "Specialist" kandidatët duhet të kenë të paktën 1 (një) vite përvojë pune në profesion.
- Për pozicionet "Përgjegjës Sektori" kandidatët duhet të kenë të paktën 2 (dye) vite pune në profesion.
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi.
- Preferohet të kenë trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse.
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat, si më poshtë:

- a) Letër interesi për pozicionin për të cilin është i interesuar kandidati.

- b) Jetëshkrim
 - c) Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (*përfshirë edhe diplomën Bachelor kur kërkohet Diploma Master Shkencor*). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit;
 - d) Fotokopje të librezës së punës (*të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
 - e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - g) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore/ Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
 - h) Referenca të punëdhënësve të mëparshëm
 - i) Adresën e saktë të vendbanimit, email dhe kontakt telefonik.
 - j) Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces në proces hetimi)
 - k) Vërtetim nga gjykata (që nuk është në proces gjyqësor).
 - l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet, nëpërmjet postës zyrtare, apo dorazi në Zyrën e Protokollit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-t ose në adresën elektronike të ASHK-t punesime@ashk.gov.al

Dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet brenda datës: 20.09.2019.

SHPALLJA E REZULTATEVE PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË KANDIDATURAVE.

Në datën **25/09/2019**, kandidatët do të njoftohen nëpërmjet publikimit në ambientet e Drejtorive Vendore përkatëse, të informacioneve në lidhje me listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, fazat e testimit, datën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurimi.